



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15660 Prot.

Lezhë, më 01.08. 2021

VENDIM

Nr 126, Datë 30.08. 2021

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetasit Ndue Preng Perndoka, banor në lagjen "Varosh", Bashkia Lezhë

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Ligji Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329,dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Ndue Preng Perndoka, banor në lagjen "Varosh", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Ndue Preng Perndoka për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën	92227 lekë.
a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë	13227 lekë.
b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje	79000 lekë.

B. Mbështetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërmat b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e Kompensimit të demit në anen ndertimore të jetë	6613 lekë.
b) Vlera e Kompensimit të demit në orendi, mobilje e pajisje	79000 lekë.
Vlera totale	85613 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhë t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Ndue Preng Perndoka me Nr.ID. E90527039D ndihmën emergjente në vlerën prej 85613 (tetedhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e trembedhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndhima financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z Ndue Preng Perndoka, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
NDUE LULI

